




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



News TV Sh.p.k
Skënder KRASNIQI
Pronar
OSHP NEWS TV
Prishtinë

News TV Sh.p.k
Servete BYTYQI
Kandidat për pronarë
Therandë

Ref: 1406/738/KPM/ni

VENDIM

lidhur me refuzimin për ndryshimin e pronësisë së OSHP NEWS TV - Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHP NEWS TV është operator kabllor, Ofrues i Shërbimeve Programore (OSHP) i cili është i licencuar për të transmetuar programin e tij përmes operatorëve kabllorë, me seli në Prishtinë. OSHP NEWS TV është pajisur nga KPM, me licencë për OSHP 18 shkurt 2009.
3. Më datën 18 prill 2014, pronari i NEWS TV SH.P.K. z. Skënder KRASNIQI ka parashtruar një kërkesë në KPM-së për bartjen e pronësisë së OSHP NEWS TV z. Skënder KRASNIQI tek znj. Servete BYTYQI.
1. Me qëllim të vërtetësisë së dokumentacionit të parashtruar për kërkesë, më datën 15 maj 2014 KPM ka nxjerrë udhëzimin për plotësim të dokumentacionit përkatës. Kandidati për licencë të KPM-së "OSHP NEWS TV", nuk ka vepruar në pajtim me udhëzimin e lartcekur të KPM-së për plotësimin e kërkesës së parashtruar.

Arsyetimi

4. KPM vlerëson se kandidati i kërkesës për ndryshimin e pronësisë së OSHP NEWS TV, nuk i ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së pasi që nuk ka arritur që brenda afatit të përcaktuar me udhëzimin e KPM-së, t'i sjellë dokumentet e vërtetuara dhe dokumentet e vlefshme sipas afatit të përcaktuar, duke vepruar në kundërshtim me udhëzimin e KPM-së të datës 15 maj 2014.

VENDIM

5. KPM merr vendim për refuzimin kërkesës për ndryshimin e pronësisë së Ofruesit të Shërbimeve Programore NEWS TV.
6. Ky vendim nuk e përjashton mundësinë e kandidatit OSHP NEWS TV që të parashtrojë kërkesë të re në të ardhmen për ndryshim të pronësisë së licencës së KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

7. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave

11.05.2014
datë